

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot më datë 18 / 04 / 2025, palët e mëposhtme nënshkruajnë këtë kontratë shitblerje kuote (në vijim referuar si "**Kontrata**"):

1. **Shoqëria "MATRIX KONSTRUKSION" SH.P.K.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS) J91306009Q, me seli në adresën: Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr. 18/2 Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë Kontratë nga Administratori **Znj. Ida Mezini**, shtetase shqiptare, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. Nikolla Jorga, Nd. 7, H. 1, Njësia Bashkiake Nr. 7, 1023; lindur më 24/07/1971, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim ID me nr. [REDACTED] dhe nr. personal [REDACTED], (këtu e në vijim referuar "**Shitësi**");

dhe

2. **Shoqëria "BLESSED INVESTMENT" SH.P.K.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS) L71423028S, me seli në adresën: Rruga "Themistokli Gërmenji", Ndërtesa Nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë Kontratë nga Administratori **Znj. Ana Lleshi**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë L.Gurakuqi, Njësia Bashkiake Nr. 2; lindur më 07/05/1981, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim ID me nr. [REDACTED] dhe nr. personal [REDACTED], (këtu e në vijim referuar "**Blerësi**").

Në vijim Shitësi dhe Blerësi do të përcaktohen bashkërisht si "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**".

Kushtet paraprake

- A. Shitësi është aktualisht pronar i një kuote në shoqërinë "OMNIX ALBANIA" Sh.p.k., një shoqëri me seli në Durrës, në adresën: Gjiri i Lalzit, Komuna Draç, Durrës, e regjistruar me NUIS K81527005D ("**Shoqëria**"). Kapitali themeltar i Shoqërisë është 2,184,212,440.00 Lekë, dhe Shitësi zotëron një kuotë me vlerë nominale 764,474,354.00 Lekë, e cila përfaqëson 35% të kapitalit të Shoqërisë;
- B. Blerësi i është drejtuar Shitësit dhe ka paraqitur një ofertë për blerjen e një pjese të kuotës që Shitësi zotëron në kapitalin e Shoqërisë sipas dhe në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Kontrate;
- C. Në vijim të bisedimeve të zhvilluara në mirëbesim ndërmjet Shitësit dhe Blerësit, Shitësi ka si qëllim t'i shesë Blerësit një pjesë të kuotës e cila përfaqëson 17.5% të kapitalit të Shoqërisë ("**Kuota Target**" ose "**Kuota**") dhe Blerësi ka si qëllim të blejë Kuotën Target nga Shitësi, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- D. Në përputhje me statutin e Shoqërisë, ortakët e tjerë të Shoqërisë kanë konfirmuar tek Shitësi se nuk do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për Kuotën Target dhe Shitësi mund ta transferojë Kuotën Target tek Blerësi.

Palët, duke marrë parasysh sa më sipër, bien dakord si në vijim:

Neni 1
Kushtet paraprake

- 1.1 Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë thelbësore dhe integrale e kësaj Kontrate.

Neni 2
Tranferimi i pronësisë së Kuotës Target

- 2.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi i transferon Blerësit i cili, pranon dhe blen, pronësinë e Kuotës Target, kundrejt një çmimi të përgjithshëm që do të përlllogaritet, sipas kushteve dhe termave në vijim.
- 2.2 Palët bien shprehimisht dakord se, titulli i pronësisë mbi Kuotën Target do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi, me efekt të menjëhershëm pas nënshkrimit të kësaj Kontrate nga të dyja palët, pavarësisht nga pagesa e çmimit. Secila Palë do të ketë të drejtë të regjistrojë transferimin e Kuotës sipas kësaj Kontrate pranë Regjistrimit Tregtar shqiptar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit ("QKB").
- 2.3 Me qëllim regjistrimit e efekteve të kësaj Kontrate pranë QKB (pra regjistrimit e pronësisë së Kuotës Target në emër të Blerësit), Palët bien dakord dhe pranojnë se do të jetë e mjaftueshme që të depozitohet në QKB kjo Kontratë.

Neni 3
Çmimi

- 3.1 Palët bien dakord se çmimi që do të paguhet nga Blerësi në favor të Shitësit për blerjen e Kuotës do të jetë 3,250,000 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) Euro ("Çmimi i Kuotës"). Pagesa e Çmimit të Kuotës do të realizohet sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë nen.
- 3.2 Palët bien dakord se Çmimi i Kuotës do t'i paguhet Shitësit në disa këste, në përputhje me mënyrat e rëna dakort në vijim si më poshtë vijon:
- a) Kësti i parë i Çmimit të Kuotës në vlerën e barabartë me 500,000 (pesëqind mijë) Euro, do të paguhet nga Blerësi brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike, duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate;
- b) Pjesa e mbetur e Çmimit të Kuotës në vlerën e barabartë me 2,750,000 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Euro, do të paguhet nga Blerësi në disa këste brenda një afati prej 2 (dy) vite nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 3.3 Çdo taksë/tatim e lidhur me Çmimin e Shitjes do të paguhet nga Shitësi sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4
Kusht Zgjidhës

- 4.1 Palët bien dakord se nëse Blerësi nuk e paguan Këstin e Parë brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.3 gërma "a" më sipër, Kontrata do të zgjidhet automatikisht dhe Palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme, sikur të mos e kishin nënshkruar asnjëherë Kontratën dhe, si rrjedhim, pronësia e Kuotës Target do të transferohet sërish në emër të Shitësit.
- 4.2 Palët marrin përsipër se nëse nuk kryhet pagesa e Këstit të Parë në favor të Shitësit brenda afatit të mësipërm, Palët do të bëjnë gjithçka është e mundur, brenda tagrave të tyre, për të regjistruar në

QKB kalimin e pronësisë së Kuotës Target serish nga Blerësi tek Shitësi duke nënshkruar çfarëdolloj akti që kërkohet nga ligji për të realizuar sa më sipër.

- 4.3 Nëse Blerësi kryen vetëm pagesën e Këstit të Parë, sipas nenit 3.3 gërma "a" dhe nuk realizon pagesën e kësteve të tjera sipas nenit 3.3 gërma "b", atëherë Blerësi merr përsipër t'i kthejë Shitësit një pjesë të pronësisë së Kuotës Target në përpjesëtim të drejtë me pjesën e Çmimit të Kuotës të papaguar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga afati i përcaktuar në nenin 3.3 gërma "b".

Neni 5 Deklarime dhe Garanci

- 5.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është pronar i vetëm dhe ekskluziv i Kuotës Target dhe të drejtave që rrjedhin prej kësaj Kuote Target.
- 5.2 Shitësi deklaron dhe garanton se Kuota Target është tërësisht e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë siguruuese, detyrim, garanci apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 5.3 Shitësi, në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë, deklaron dhe garanton përpara Blerësit se në datën e nënshkrimit, lidhja e kësaj Kontrate nga Palët përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Palët, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj dhe legjislacionin në fuqi.
- 5.4 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se në datën e nënshkrimit Blerësi ka të gjitha kompetencat dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë Kontratë dhe zbatojë detyrimet e saj. Kjo Kontratë është e autorizuar dhe nënshkruar nga Blerësi dhe përbën një detyrim të ligjshëm, të vlefshëm dhe detyrues për Blerësin, të zbatueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e saj.
- 5.5 Palët deklarojnë se informacioni, të dhënat dhe dokumentat që përfshihen në këtë Kontratë janë të vërteta, të përditësuara dhe të plota, deri në këtë datë.

Neni 6 Të ndryshme

- 6.1 Kjo Kontratë dhe dokumentet e referuara në të, përbëjnë detyrimin e plotë të Palëve në lidhje me objektin e saj dhe do të zëvendësojnë çdo shprehje interesi të mëparshëm ose marrëveshje në lidhje me këtë transaksion. Çdo ndryshim apo heqje dorë nga ndonjë prej kushteve të saj apo miratimeve të dhëna sipas kësaj Kontrate (përfshirë pa kufizim edhe këtë seksion) do të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dy Palët.
- 6.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen në adresat përkatëse të Blerësit dhe të Shitësit, nëpërmjet letrës rekomande me kthim përgjigje ose postës elektronike.
- 6.3 Çdo njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse verifikohen kushtet e mëposhtme: a) nëse është dërguar me postë elektronike, në momentin në të cilin është marrë posta elektronike; b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.
- 6.4 Shpenzimet noteriale për lidhjen e Kontratës do të ndahen në mënyrë të barabartë midis Palëve.

Neni 7 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1 Palët marrin përsipër të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet eskluzivisht nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.



Neni 8
E drejta e zbatueshme

8.1 Kjo Kontratë dhe të drejtat e detyrimet e Palëve do të rregullohen në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9
Vlefshmëria – Kopjet origjinale

9.1 Kjo Kontratë bëhet e vlefshme me nënshkrimin e saj nga Palët. Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën Palë.


SHITËSI

Shoqëria “MATRIX KONSTRUKSION” SH.P.K.

Përfaqësuar nga

Znj. Ida Mezini

Administrator





BLERËSI

Shoqëria “BLESSED INVESTMENT” SH.P.K.

Përfaqësuar nga

Znj. Ana Lleshi

Administrator



